



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1697/2 Prot

Rrëshen, më 29.04.2026

V E N D I M

Nr. 29 datë 24. 04. 2024

PËR
“MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS
TË BASHKISË MIRDITË”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenet 9, 15 dhe 18/3, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenet 4, 5, 6 dhe 7, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, si dhe në Programin Model të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për programin e transparencës të Bashkisë Mirditë me nr. 1697 prot, datë 15. 04. 2026, pas diskutimeve në mbledhjen e Këshillit Bashkiak;

V E N D O S I:

1. Miratimin e Programit të Transparencës të Bashkisë Mirditë, bashkëlidhur, Programi i Transparencës i Bashkisë Mirditë, me nr. 1697 prot, datë 15. 04. 2026, pjesë përbërse e këtij vendimi
2. Për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Kryetari i Bashkisë Mirditë

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1694 Prot.

Rrëshen më, 15 . 04 . 2026

P/VENDIM

Nr. 38 datë 15 . 04 . 2026

“PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS
TË BASHKISË MIRDITË”.

Në mbështetje të neneve 9, 15 dhe 18/3, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, nenet 4, 5, 6 dhe 7, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, si dhe në Urdhrin nr. 281, datë 30.12.2025, mbi Programin Model të Transparencës, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me propozim të kryetarit të bashkisë Mirditë, pas diskutimeve në seancë të këshillit bashkiak;

V E N D O S I:

1. Miratimin e Programit të Transparencës të bashkisë Mirditë, *bashkëlidhur, Programi i Transparencës i Bashkisë Mirditë*, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Bashkia Mirditë.

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETARI

Gaspër TOPOLLAJ

KRYETARI

Aleksandër PICAKU

Paraqitën Projektin:

Koordinatorë për të Drejtën e Informimit: Ardiana LASKA

P/Spektori

i Marrëdhënieve me qytetarët, eventeve dhe IT: Nertila BEQIRI

KRYETARI

Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email: info@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË

Nr. 1697 Prot.

Rrëshen, më 15.04.2026

MIRATOI
KRYETARI
ALBERT MELYSHI

PROGRAMI I TRANSPARENCËS I BASHKISË MIRDITË



Transparenca institucionale përbën një nga parimet bazë të qeverisjes së mirë, sipas të cilës institucionet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të hapur dhe garantojnë akses të plotë, të saktë dhe të kuptueshëm të qytetarëve në informacion mbi vendimmarrjen, aktivitetet dhe menaxhimin e fondeve publike. Ky parim synon forcimin e llogaridhënies publike dhe nxitjen e pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse.

Në nivel vendor, transparenca realizohet përmes publikimit të rregullt dhe të përditësuar të informacionit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke u mundësuar qytetarëve të njihen me veprimtarinë e institucioneve vendore dhe me ushtrimin e kompetencave të tyre. Kjo kontribuon në rritjen e përgjegjshmërisë dhe besueshmërisë institucionale.

Programi i Transparencës përbën një instrument të rëndësishëm për garantimin e publikimit të informacionit dhe dokumenteve me interes publik, lehtësimin e aksesit në informacion dhe reduktimin e nevojës për paraqitjen e kërkesave individuale për informacion, duke forcuar njëkohësisht parimin e llogaridhënies.

Në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Urdhrit nr. 281, datë 30.12.2025, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe me qëllim standardizimin dhe përmirësimin e praktikave të transparencës, Bashkia Mirditë ka kryer rishikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës, duke reflektuar shtesat dhe përshtatjet e nevojshme për forcimin e mëtejshëm të transparencës institucionale.

Bashkëlidhur gjeni Programin e Transparencës së Bashkisë Mirditë.

TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENÇËS



BASHKIA MIRDITË

Fasha I - Mbiorganizimin dhe funksionimin e Bashkisë Mirditë					
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1	<p>Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet. NJVV bën publike:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ndarjen administrativo-territoriale <ul style="list-style-type: none"> Njësitë administrative dhe nën-ndarjet e tyre Të drejtat, përgjegjësitë dhe misionin e NJVV. Funksionet: Përfshin bërjen publike të: <ul style="list-style-type: none"> Funksioneve në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike Funksioneve në fushën e shërbimeve sociale Funksioneve në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese Funksioneve në fushën e mbrojtjes së mjedisit Funksioneve në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit Funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik vendor Funksioneve në fushën e sigurisë publike Funksionet dhe kompetencat e deleguara 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	Menjëherë	Sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Kryetari i Bashkisë
2	Organi ekzekutiv (Titulari i NJVV). Përfshin bërjen publike të:				

<ul style="list-style-type: none"> - Procedurave të zgjedhjes - Detyrat dhe kompetencat - Të dhënat për arsimin, kualifikimet , paga e Titullarit dhe deklarimi i pasurisë - Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ - Orari i pritjes së qytetarëve - Adresa postare/ elektronike 				<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Sekretari i përgjithshëm i Bashkisë</p>
<p>3</p> <p>Administrata e NJVV. Përshin bëjjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Strukturës organizative dhe numrin e punonjësve - Rregullores së organizimit dhe funksionimit të administratës - Strukturës së pagave - Orarit të punës së NJVV, njësjve administrative dhe njësjve të varësisë - Detyrave të administratës së njësjve administrative - Organizimit dhe funksionimit të njësjve në varësi - Njoftimeve mbi vende të lira pune dhe procedurat e rekrutimit - Adresave postare dhe elektronike e zyrave të NJVV/njësive administrative/ njësjve në varësi të NJVV - Drejtuesit e zyrave, njësjve administrative dhe njësjve të varësisë 	<p>Menjëherë</p>	<p>c) Në faqen zyrtare të internetit - menuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>a) për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit - menuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
<p>4</p> <p>Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit. Përshin bëjjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kartës së Auditimit të Brendshëm - Kodit të Etikës për audituesit e brendshëm - Planit strategjik dhe vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm - Çdo raport të auditimit të brendshëm të ushtruar në NJVV - Çdo raport përfundimtar të kontrollit të jashtëm (KLSH) të ushtruar në NJVV 	<p>Brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit - menuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>

5	<p>Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm</p> <p>Kërkesa, ankesa, sinjalizime dhe vërejtje që lidhen me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës. Përfshin bërjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Procedurave për të bërë kërkesë, ankesë, vërejtje dhe sinjalizime organeve të NJVV Rregullores së brendshme për procedurën e shqyrtimit, të hetimit administrativ, të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit Njësisë përgjegjëse që regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet Adresave postare/ elektronike për depozitim të kërkesave, ankesave, sinjalizimeve apo vërejtjeve Afateve dhe mënyrave të kthimit të përgjigjeve në lidhje me kërkesat, ankesat apo vërejtjet 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamirdi.te.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Sekretari i përgjithshëm i Bashkisë
6	<p>Statistikat vendore. Përfshin bërjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Kalendarit të publikimit të statistikave vendore Statistikave vendore me të dhënat kyçe të NJVV sipas fushave kryesore dhe të ndara sipas gjinisë Strukturës përgjegjëse në NJVV për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit menuja... www.bashkiamirdi.te.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	Menjëherë pas miratimit	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë
Fusha 2 - Transparenca dhe Illogjridhënia ekonomiko-financiare					
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Mënyra e bërjes publike së këtyj informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1	Kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamirdi.te.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike</p>	Në 10 ditëshin e parë të janarit	Këshilli i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë

2	<p>Paketa fiskale (taksa dhe tarifa). Përfshin bërijen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bazës së taksave dhe tarifave 2. Nivelit të taksave dhe tarifave 3. Përfshirjeve dhe lehtësimeve të subjekteve të caktuara 4. Afateve të pagesave 5. Gjorbave dhe kamatëvesave të aplikueshme 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	<p>Brenda 15 ditëve nga miratimi</p>	Këshilli i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë
3	<p>Plani Strategjik i Zhvillimit të NJVV. Përbër:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm në një afat kohor jo më pak se 5 vite 2. Synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësi 3. Veprimet që duhen ndërmarrë duke parashikuar edhe kostot përkatëse 4. Burimet e financimit 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkia.mirdite.gov.al</p>	<p>10 ditë nga data e miratimit</p>	Këshilli i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë
4	<p>Programi buxhetor afatmesëm vendor. Përfshin bërijen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumentit të parë të programit buxhetor 2. Dokumentit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm 3. Dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm (përfshirë dokumentacionin shoqërues) dhe informacionit për dy vitet e fundit, vitin buxhetor dhe tre vitet vijuese për çdo program (5 dokumentat përkatës) 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	<p>Dokumenti i parë brenda datës 5 korrik. Dokumenti i rishikuar. Dokumenti i plotë jo më vonë se data 31 dhjetor.</p>	Këshilli i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë
5	<p>Buxheti. Përfshin bërijen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Buxhetit vjetor së bashku me dokumentacionin shoqërues të tij (12 dokumentat përkatës) 2. Treguesve financiarë 3. Numrit të punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese 4. Regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p> <p>c) Në Buletinin e Njoftimeve Publike</p>	<p>15 ditë pas miratimit nga Këshilli i NJVV. Regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit.</p>	Këshilli i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë

6	<p>Zbatimi i buxhetit. Përfshin bërgjen publike të:</p> <p>1. Raportit mujor (pas datës 30 prill të çdo viti buxhetor) të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve (8 raporte)</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menjuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	<p>Jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës</p>	<p>Kryetari i Bashkisë Informohet Këshilli i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
7	<p>Monitorimi dhe mbikëqyrje e buxhetit:</p> <p>1. Raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit (jo më pak se tre raporte katër-mujore)</p> <p>2. Raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit</p> <p>2.1. Raportit të performancës vjetore</p> <p>2.2. Pasqyrave financiare vjetore (dokumentacionin bazë dhe shoqërues)</p> <p>3. Informacionit për zbatimin dhe monitorimin e kontratave (punëve publike, mallrave, shërbimeve)</p> <p>4. Regjistrin të realizimeve të procedurave të prokurimit publik</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menjuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	<p>Raportet e monitorimit brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit.</p> <p>Raportit vjetor i konsoliduar brenda muajit qershor të vitit buxhetor pasardhës.</p> <p>Regjistri i realizimeve të procedurave të prokurimit publik jo më vonë se datat 10 maj, 10 shtator dhe 10 janar të çdo viti.</p>	<p>Raportet e monitorimit të zbatimit. Kryetari i Bashkisë (Informohet Këshilli i Bashkisë)</p> <p>Raportit vjetor i konsoliduar miratohet nga këshilli i Bashkisë</p> <p>Regjistri i realizimeve të prokurimit. Titullari i NJVV (Informohet Këshilli i Bashkisë)</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
8	<p>Vështrësitë financiare. Përfshin bërgjen publike të:</p> <p>1. Planit për daljen nga situata e vështirë financiare</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menjuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	<p>Brenda 10 ditëve nga shpallja.</p>	<p>Këshilli i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>

9	<p>Shitja ose dhënia me qira e pronave dhe asetëve Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aseteve dhe pronave të ofruara për shitje ose dhënie me qira 2. Kriteve që duhet të plotësohen 	<p>c) Në Buletinin e Njoftimeve Publike a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkaimirdi te.gov.al b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve) c) Në Buletinin e Njoftimeve Publike</p>	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë	
10	<p>Donacionet. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emrit të donatorit 2. Shumës së donacionit 3. Qëllimit e donacionit 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkaimirdi e.gov.al b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i Njoftimeve)</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	
Fusha 5- Për kërkesat për informim					
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1	<p>Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit (Emri, kontaktet dhe kompetencat) Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emrit mbiemrit të Koordinatorit 2. Adresës postare/elektronike të tij 3. Orarit të punës 4. Detyrave dhe kompetencave të Koordinatorit Adresës postare/elektronike për depozitimin e kërkesave për informim	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkaimirdi te.gov.al b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i Njoftimeve)</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit

2	Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankesës. Përfshin bërijen publike të:	Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkajmirajtje.gov.al	Brenda 48 orëve prej miratimit të tyre	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
---	--	--	--	---------------------	--

	<p>1. Procedurës që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion</p> <p>2. Adresës postare/elektronike për dërgimin e kërkesës për informim</p> <p>3. Modelit standard të një kërkesë për informim</p> <p>4. Afateve të marrjes së përgjigjes</p> <p>5. Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankesë për mos dhënie informacioni</p> <p>Adresës postare/elektronike për dërgimin e ankesës për mos dhënie informacioni</p>	<p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>			
3	<p>Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve. Përfshin bërtjen publike të:</p> <p>1. Të gjitha kërkesave për informim</p> <p>2. Informacionet e dhënë në përgjigje të kërkesave për informim</p> <p>Përditësimi i regjistrit</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkaimirdit.e.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Kordinatori për të drejtën e informimit
4	<p>Tarifa për dhënie e informacionit (nëse ka) Përfshin bërtjen publike të:</p> <p>1. Tarifave</p> <p>2. Rregullave për mënyrën e kryerjes së pagesës</p> <p>Subjekteve që përfitojnë informacionin falas</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkaimirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Kordinatori për të drejtën e informimit
Fusha 4 - Mbi shërbimet që ofron NJVV					
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1	<p>Shërbimet</p> <p>Përfshin bërtjen publike të shërbimeve publike që ofron NJVV sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015</p> <p>1) Shërbimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike</p> <p>2) Shërbimet në fushën e shërbimeve sociale</p> <p>3) Shërbimet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkaimirdit.e.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë



	<p>4) Shërbimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit</p> <p>5) Shërbimet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit</p> <p>6) Shërbimet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor</p> <p>7) Shërbimet në fushën e sigurisë publike</p> <p>8) Shërbimet në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.....</p> <p>Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkruet mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Instrumentin për administrimin e shërbimit ✓ Sistemin e administrimit të performancës së shërbimit bazuar mbi standardet ✓ Sistemin e treguesve, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës ✓ Strukturën përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor 	<p>për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>		
2	<p>Shërbimet administrative</p> <p>Përfshin bëjen publike të shërbimeve publike që ofron NJVV sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shërbimet administrative në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike 2) Shërbimet administrative në fushën e shërbimeve sociale 3) Shërbimet administrative në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese 4) Shërbimet administrative në fushën e mbrojtjes së mjedisit 5) Shërbimet administrative në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit 6) Shërbimet administrative t në fushën e zhvillimit ekonomik vendor 7) Shërbimet administrative në fushën e sigurisë publike <p>Shërbimet administrative në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara</p> <p>Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkruet mbi:</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menjuja... www.bashkaimirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë

	<ul style="list-style-type: none"> - Strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimit - Adresën postare/elektronike të strukturave/njësive/sportevele që ofrojnë shërbime administrative - Procedurat që duhen ndjekur për të përfutuar shërbime administrative - Oraret e punës së strukturave/njësive/sportevele që ofrojnë shërbime administrative - Tarifat për shërbimet administrative - Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës - Subjektet që përjashtohen nga tarifat 			
3	<p>Kontratat publike. Përfshin bërjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objektivit të kontratës publike - Numrit të referencës së procedurës/ kontratës - Llojit të procedurës - Termave dhe kushteve të kontratës - Kohëzgjatjes së kontratës - Vlerës së kontratës - Dhënave të autoritetit kontraktor - Dhënave të kontraktorit/nënkontraktorit - Treguesve për matjen e përmbushjes së kontratës - Strukturave publike përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës - Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankimim - Raporteve të kontrollit, monitorimit dhe auditimit mbi zbatimin e kontratës 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamiri.dite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	Publikimi brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës	Kryetari i Bashkisë
4	<p>E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Procedurave për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet 2. Adresës postare/elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamirdi.te.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	Brenda 10 ditëve nga shpallja e miratimit	Kryetari i Bashkisë

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1	<p>Legjislativi dhe aktet e brendshme rregullatore:</p> <p>1) I organizuar (jo i detyrueshëm) sipas fushave:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fusha e organizimit dhe funksionimit të NJVV - Fusha e veprimtarisë ekonomiko-financiare - Fusha e qeverisjes së mirë vendore (integriteti, etika, anti-korrupsioni, transparencë, llogaridhënia etj) - Fusha e infrastrukturës dhe shërbimeve publike - Fusha e shërbimeve sociale - Fusha e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese - Fusha e mbrojtjes së mjedisit - Fusha e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit - Fusha e zhvillimit ekonomik vendor - Fusha e sigurisë publike - Fusha e funksioneve dhe kompetencave të deleguara <p>2) Çdo fushë duhet të përbëjë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse - Dokumentet politike kombëtar përkatës - Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit të NJVV-së me karakter normativ - Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e Titullarit të NJVV-së me karakter normativ - Dokumentet politike vendor 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndit njoftimeve)</p>	<p>Menjherë pas botimit në fletore zyrtare.</p> <p>Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit dhe Titullarit të NJVV-së brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre</p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p> <p>Këshilli i Ministrave</p> <p>Ministri</p> <p>Këshilli i Bashkisë</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
Fusha 6 - Pjesëmarrja qytetare në vendimtarje					
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1	<p>Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emër mbiemër të koordinatorit 2. Adresën postare/ elektronike të tij 3. Orarin e punës 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara</p>	<p>Menjherë pas miratimit të urdhrat të caktimit të Koordinatorit</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>

	për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli i Bashkisë Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit të Bashkisë Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
<p>2</p> <p>Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Akteve që do të konsultohen 2. Mënyrat e konsultimit 3. Afatet <p>Strukturat përgjegjëse</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>			
<p>3</p> <p>Dispozitat e brendshme rregullatorë për këshillimin me publikun. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Procedurave, afateve dhe mënyrat e organizimit për çdo formë/lloj konsultimi <p>Strukturat përgjegjëse për aktet e detyrueshme për konsultim</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>a) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	<p>Brenda 10 ditëve nga data e miratimit</p>	<p>Këshilli i Bashkisë Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Sekretari i Këshillit të Bashkisë Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>
<p>4</p> <p>Akte për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Listës së akteve për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik 	<p>Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>a) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	<p>Menjëherë</p>	<p>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>	<p>Sekretari i Këshillit të Bashkisë Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>

5	<p>Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Projektaktit, relacionin shpjegues dhe dokumentave shoqërues të tij. 2. Arsyeve të nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë 3. Afatit, vendit dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre; 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	Menjëherë	<p>Këshilli i Bashkisë Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Sekretari i Këshillit të Bashkisë Kordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>
---	--	---	-----------	--	---

	<p>4. Adresën e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të i NJVV ose të strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin; 5. Vendin dhe datën e organizimit të takimit publik në rastet kur NJVV vendos për organizimin e tij</p>				
6	<p>Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve. Përfshin bërijen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Adresën postare/ elektronike për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve 2. Afatin për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve 3. Mënyrën e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit të takimit publik për takimet publike 4. Mënyrën e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve <p>Mënyrën e dhënies së arsyeve për mospranimin komenteve dhe rekomandimeve</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- www.bashkiamirdite.go.v.al b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	Menjëherë	Këshilli i Bashkisë	Sekretari i Këshillit të Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
7	<p>Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim në lidhje me konsultimin publik. Përfshin bërijen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Subjektet ku mund të bëhet ankesa (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Këshilli i i NJVV, Titullari i i NJVV;) 2. Adresën postare/ elektronike për dërgimin e ankesës 3. Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me këshillimin me publikun 4. Struktura përgjegjëse në nivel NJVV që regjistron dhe shqyrton ankesën 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- www.bashkiamirdite.go.v.al b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (Këndi i njoftimeve)</p>	Menjëherë	Këshilli i Bashkisë	Sekretari i Këshillit të Bashkisë Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

8	<p>Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes. Përfshin bëjten publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Numrit të akteve të miratuara nga organet e NJVV me konsultim publik gjatë një viti. 2. Numrin e përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara; 	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja... www.bashkiamirdite.gov.al</p> <p>b) Vendet e caktuara</p>	<p>Brenda 10 ditëve nga data e miratimit</p>	<p>Këshilli i Bashkisë Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Sekretari i Këshillit Bashkiak Kordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>
---	--	--	--	--	--

